

**V E N D I M**  
**Nr. 695, datë 27.12.2002**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 766, DATË 8.12.1998 TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGESËN E PUNONJËSVE TË DISA LINJAVE  
TEKNOLOGJIKE USHTARAKE TË RËNDËSISË SË VEÇANTË"**

Në mbështetje të nenit 100 pika 2 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr. 8487, datë 13.7.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Në vendimin nr. 766, datë 8.12.1998 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në paragrafin e dytë të pikës 1, afati "...deri në 31.12.2002" zëvendësohet me "...deri në 31.12.2003".

b) Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

"3. Pagesën e gatishmërisë e përfitojnë 900 punonjës të kombinatit mekanik në Poliçan, 60 punonjës të uzinës së lëndëve plasëse në Elbasan, 70 punonjës të uzinës mekanike në Gramsh, 20 punonjës të uzinës së pilave në Gramsh dhe 50 punonjës të uzinës së riparimit të aviacionit në Kuçovë".

c) Në fund të pikës 4 pas fjalës "...papunësie" të shtohet fjalia "Këta punonjës nuk përfitojnë nga rritja e pagave të punonjësve buxhetorë për vitin 2003".

2. Fondi prej 169 000 000 (njëqind e gjashtë dhjetë e nëntë milionë) lekësh, i nevojshëm për përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohet nga fondet e miratuara për vitin 2003, për Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2003.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**